

VENDIM
Nr. 9, datë 11.5.2018

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 17, DATË 12.4.2017, TË KOMITETIT PËR
ZHVILLIMIN E RAJONEVE “PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTE
TË REJA, THIRRJA I PËR VITIN 2017, TË GRANTIT “SHQIPËRIA DIXHITALE”,
PROGRAMI “SHQIPËRIA DIXHITALE”, SHTYLLA II”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 109 datë 30.11.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozim të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1 që i bashkëlidhet vendimit nr. 17, datë 12.4.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I për vitin 2017, të grantit “Shqipëria dixhitale”, programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla II”, bëhen ndryshimet, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Senida Mesi

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave dhe Ekonomisë	anëtar;
Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	anëtar;
Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	anëtar;
Ministri i Brendshëm	anëtar;
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Përfaqësuesi i Fondit Shqiptar të Zhvillimit	Anëtar.

Tabela 1

Në tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 17, datë 12.4.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I për vitin 2017, të grantit “Shqipëria dixhitale”, programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla II”, projektit nr. 5, i anulohet financimi dhe bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

“Tabela 1. Lista e projekteve të reja, thirrja e I për vitin 2017, për grantin “Shqipëria dixhitale”, programi “Shqipëria dixhitale”, me cikël zbatimi 2017–2018”

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit në FZHR (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
5	Bashkia Tiranë	Sistem i qendëruar për monitorimin e detyrimeve të prapambetura dhe përmirësimin e kontrollit (anulohet)	0	0	0
	TOTALI		194,355,813	168,171,519	144,174,630

Shënime:

1. Anulimi i financimit për këtë projekt bëhet me kërkesë të sekretariatit teknik pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, nr. 509/1 prot., datë 8.5.2018.

2. Numri rendor i totalit të projekteve në tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, ndryshon nga 5 projekte në 4 projekte dhe projektet rinumërohen përkatësisht.